

VENDIM
Nr. 500, datë 24.6.2020

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I
OBJEKTIT “SISTEMIM, ASFALTIM RRUGA HYRËSE BERAT” (SHITESAT)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorin të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i objektit “Sistemim, asfaltim rruga hyrëse Berat” (shtesat).

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, prone private, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqiten në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit “truall”, me vlerë të përgjithshme prej 2 493 068 (dy milionë e katërqind e nëntëdhjetë e tre mijë e gjashtëdhjetë e tetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 2 493 068 (dy milionë e katërqind e nëntëdhjetë e tre mijë e gjashtëdhjetë e tetë) lekësh, të përballohet nga fondet buxhetore të miratuara në zërin “Shpronësim” për Autoritetin Rrugor Shqiptar, në programin buxhetor “Transporti rrugor”, për vitin 2020.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga fondet e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe shpenzimi në vlerën 329 000 (treqind e njëzet e nëntë mijë) lekë, për botimin në gazetë, të përballohet nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit të jetë 3 (tre) muaj pas datës së hyrjes në fuqi të tij.

7. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara në projekt.

8. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim, pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

9. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Berat, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Berat, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

11. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Berat, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Lista e pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i objektit:

“Sistemim, asfaltim rruga hyrëse Berat” (shitesat)

Nr.	Emër mbiemër	Lloji i pasurisë	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip. totale truall (m ²)	Sip. truall i prekur (m ²)	Çmimi truall lekë/m ²	Vlera në lekë	Shënime në kartelë
1	Ruzhdi Oriza	Truall	8501	2/175	38	31.00	4183	129,673.0	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
2	Pranvera Tosun Sojati dhe Vladimir Avni Sojati	Truall	8501	2/164	220.60	83.00	4183	347,189.0	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
3	Besim Barjam Sherifi	Truall	8501	2/166	66	20.00	4183	83,660.0	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
4	Besim Barjam Sherifi	Truall	8501	2/176	49	15.00	4183	62,745.0	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
5	Ganimete Kamber Oriza	Truall	8501	5/1	9224	447.00	4183	1,869,801.0	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
Total						596	m ²	2,493,068	lekë

Shënim:

1. Për truallin, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja nr. 89, dt. 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.